

Prishtinë, 01 Nëntor, 2007  
 Kodi ZRRë-së: D\_70\_2007

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit Nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
2. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I\_04\_2007 “Mbi Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I\_05\_2007 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Çmimeve dhe Tarifave në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2007/2008”;
4. Raportimin Rregullativ dorëzuar nga NQ “Termokos” SH.A, Zyrës së Rregullatorit për Energji duke përmbajtur informatën për të ardhurat dhe shpenzimet, për asetet, investimet, informatat teknike dhe për konsumatorë që u realizuan në sezonin e ngrohjes 2006/2007;
5. Aplikimin për tarifa për sezonin 2007/2008 dorëzuar nga NQ “Termokos” SH.A, Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke përmbajtur informacione lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara, asetet / planin investues, dhe prodhimin e furnizimin e parashikuar të ngrohjes, **në seancën e mbajtur me datë 01 nëntor 2007, nxori këtë:**

### VENDIM

#### 1. Aprovohen të Ardhurat e Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Termokos SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2007/2008

R	Të Ardhurat e Lejuara	5,223,761
R <sub>F</sub>	Pjesa Fikse e të Ardhurave të Lejuara	723,319
R <sub>V</sub>	Pjesa Variable e të Ardhurave të Lejuara	4,500,442

2. Ky vendim do të botohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së;
3. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.

4. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
5. Ky Vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së

Vendimit i bashkëngjitet Raporti Rregullativ i NQ ”Termokos”Sh.A për sezonin e Ngrohjes 2007/2008.

Bordi i ZRrE-së:

---

Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Naim Bejtullahu, Anëtar

---

Nysret Avdiu, Anëtar